



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR TË DREJTEN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN
E TË DHËNAVE PERSONALE

Nr. 794/5 Prot.

Tiranë, më 16/10/2015

REKOMANDIM

Nr. 35, datë 16/10/2015

Në mbështetje të neneve 29, 30 dhe 32 të Ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008 "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*" (i ndryshuar), Ligjit nr. 8485, datë 12/05/1999 "*Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë*", të procesverbalit të hetimit administrativ dhe provave të administruara në ngarkim të kontrolluesit "*Rezidenca Studentore Universitare nr.1*" sh.a., Tiranë.

VËREJSE

Në zbatim të Urdhrit nr. 176, datë 09/09/2015 të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, është kryer hetim administrativ pranë kontrolluesit "*Rezidenca Studentore Universitare nr.1*" sh.a., me objekt:

- Plotësimi i detyrimit për informim, (Neni 18) i Ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008 "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*" (i ndryshuar) dhe zbatimimi i Udhëzimit nr. 3, datë 05/03/2010 "*Mbi përpunimin e të dhënave personale me sistemin e video survejimit në ndërtesa dhe mjedise të tjera*" (i ndryshuar);
- Plotësimi i detyrimit për njoftim, (Nenet 21, 22) të Ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008 "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*" (i ndryshuar).

Zyra e Komisionerit vlerëson rëndësinë e përpunimit të të dhënave personale imazhe-video nëpërmjet sistemeve mbikëqyrëse (CCTV), në kuadër të impaktit që ka ky lloj përpunimi mbi subjektet e të dhënave. Mbikëqyrja e ambienteve nëpërmjet sistemit (CCTV), duhet të jetë në përputhje me Ligjin nr. 9887, datë 10/03/2008 "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*" (i ndryshuar) dhe Udhëzimin nr. 3, datë 05/03/2010 "*Mbi përpunimin e të dhënave personale me sistemin e video survejimit në ndërtesa dhe mjedise të tjera*" (i ndryshuar) etj., në mënyrë që të bëhet një përpunim i ligjshëm i të dhënave, duke respektuar dhe garantuar të drejtat dhe liritë themelore të njeriut dhe në veçanti, të drejtën e ruajtjes së jetës private.

Zyra e Komisionerit e vlerëson "*detyrimin për njoftim*" (referuar nenit 21 dhe 22 të Ligjit nr. 9887 datë 10/03/2008 "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*", i ndryshuar) si një nga detyrimet bazë të kontrolluesit pasi plotësimi i tij përbën kusht për garantimin e të drejtës për informim të subjekteve të të dhënave personale. Për rrjedhojë, përditësimi i "*Formularit të Njoftimit*" pranë zyrës së K.D.I.M.D.P, në varësi të ndryshimeve në strukturë, kategori subjektsh të dhënash, kategori të dhënash personale etj., është një proces tepër i rëndësishëm për kontrolluesin.

Kontrolluesi “*Rezidenca Studentore Universitare nr.1*” sh.a, është person Juridik që e ushtron aktivitetin në kuadër të ofrimit të shërbimeve ndaj studentëve me qëllim realizimin e akomodimit të tyre. Në këtë kuadër mbledh dhe përpunon të dhëna personale për kategorinë studentë dhe punonjës.

Me qëllim garantimin e sigurisë së pronës dhe kufizimin e personave të paautorizuar për të aksesuar ndërtesat në të cilat banojnë studentët, kontrolluesi është duke instaluar një sistem video-vëzhgimi (CCTV). Gjatë kontrollit është konstatuar se sistemi i video-vëzhgimit nuk është funksional për arsye se nuk kanë përfunduar punimet për lidhjen e kamerave me sistemin regjistruar-monitorues NVR (network video recorder – video regjistruar rrjeti).

Në hyrjet e godinave janë konstatuar tabela informuese mbi prezencën e sistemit video-mbikëqyrës të ambientit me kamera (CCTV). Tabela informuese nuk rezultoi sipas modelit standard të miratuar nga K.D.I.M.D.P. dhe për këtë arsye nuk realizon qëllimin e informimit të subjekteve të të dhënave personale sa i përket të drejtave që ata kanë dhe detyrimeve të kontrolluesit “*Rezidenca Studentore Universitare nr.1*” sh.a, duke i privuar mundësinë për të kontaktuar me kontrolluesin në rast ankesash të mundshme.

Zyra e Komisionerit nëpërmjet “*Procesverbalit të Hetimit Administrativ*” konstatoi se nuk është zbatuar plotësisht dhe saktë pika “1” e nenit 21 (Përgjegjësia për të njoftuar) dhe neni 22 (Përmbajtja e Njoftimit) të Ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008 “*Për Mbrojtjen e të dhënave personale*” (i ndryshuar), sipas të cilit: “...Çdo kontrollues duhet të njoftojë Komisionerin për përpunimin e të dhënave personale, për të cilat është përgjegjës. Njoftimi duhet të bëhet para se kontrolluesi të përpunojë të dhënat për herë të parë ose kur kërkohet ndryshimi i gjendjes së njoftimit të përpunimit, sipas nenit 22 të këtij ligji, të njoftuar më parë”.

Në seancën dëgjimore të zhvilluar në datën 07/10/2015 (ora 10:00) në ambientet e Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, përfaqësuesi i kontrolluesit depozitoi në cilësinë e provës materiale “*Përditësimin e Formularit të Njoftimit*” dhe “*Modelin e tabelave informuese për kamerat*”. Pas analizimit të tyre dhe bazuar edhe në pretendimet e përfaqësuesit, Zyra e Komisionerit vlerëson se:

- Janë marrë masa sa i përket përditësimit të formularit të njoftimit në zbatim të nenit 21 të Ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008 “*Për Mbrojtjen e të dhënave personale*” (i ndryshuar);
- Janë marrë masa konkrete në kuadër të reflektimit të ndryshimeve përkatëse në “*Formatin e tabelave informuese për kamerat*”, në përputhje me standardin e miratuar nga Komisioneri nëpërmjet Udhëzimit nr. 3, datë 05/03/2010 “*Mbi përpunimin e të dhënave personale me sistemin e video survejimit në ndërtesa dhe mjedise të tjera*” (i ndryshuar);

Zyra e Komisionerit vlerëson se në kuadër të garantimit të sigurisë së të dhënave personale të përpunuara nëpërmjet sistemit (CCTV), është e nevojshme që kontrolluesi të hartojë rregulla specifike të shkruara mbi sigurinë e përpunimit, ruajtjen e konfidencialitetit, të drejtat e aksesit, afatet e mbajtjes së të dhënave personale të përpunuara nëpërmjet sistemit (CCTV), etj, në zbatim të detyrimeve që parashikon Ligji nr. 9887, datë 10/03/2008 “*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*” (i ndryshuar) dhe Udhëzimit nr. 3, datë 05/03/2010 “*Mbi përpunimin e të dhënave personale me sistemin e video survejimit në ndërtesa dhe mjedise të tjera*” (i ndryshuar).

Zyra e Komisionerit e vlerëson pozitivisht angazhimin, bashkëpunimin dhe reagimin e shpejtë të kontrolluesit në kuadër të plotësimit të detyrimeve ligjore.

Sa më sipër,

Në zbatim të neneve 29, 30 dhe 31/a/1 të ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" (i ndryshuar), si dhe nenet 107-109 të K. Pr. Administrative:

REKOMANDOJ

- 1) Në zbatim të Udhëzimit nr. 3, datë 05/03/2010 "Mbi përpunimin e të dhënave personale me sistemin e video survejimit në ndërtesa dhe mjedise të tjera" (i ndryshuar):
 - Të hartohen rregulla specifike të shkruara mbi sigurinë e përpunimit, ruajtjen e konfidencialitetit dhe të drejtat e aksesit në sistemin (CCTV) (në zbatim edhe të nenit 27-28 të ligjit).;
 - Të mos tejkalohet koha e ruajtjes së të dhënave (dy muaj) parashikuar në këtë udhëzim;
 - Të dokumentohet përhapja e të dhënave imazhe-video ndaj palëve të treta ligj zbatuese si Prokurori, gjykatë, polici;
 - "Formati i tabelave informuese për kamerat", të vendoset në të gjitha ambientet e mbikëqyrura me kamera, me qëllim informimin e subjekteve të të dhënave personale (në zbatim edhe të nenit 18 të ligjit).
- 2) Në zbatim të neneve 21 dhe 22 të Ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" (i ndryshuar), të tregohet kujdes në vijimësi në përditësimin e "Formularit të Njoftimit" pranë Zyrës së Komisionerit.
- 3) Në zbatim të nenit 32/1 të Ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" (i ndryshuar), të kryhet plotësimi i këtyre detyrimeve brenda një afati 30 ditor, nga momenti i njoftimit të këtij Rekomandimi dhe pas këtij afati të njoftohet me shkrim pranë Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale.
- 4) Në rast mos përmbushje të këtyre detyrimeve, Komisioneri vepron sipas nenit 30, pika 2 të Ligjit nr. 9887 datë 10/03/2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" (i ndryshuar). Komisioneri në rast shkeljesh serioze të përsëritura ose të qëllimshme të ligjit nga një kontrollues ose përpunues, veçanërisht, në rastet e përsëritura të moszbatimit të rekomandimeve të tij, vendos sanksion me gjobë, për kundërvajtjet administrative dhe e denoncon publikisht ose e raporton çështjen në Kuvend dhe në Këshillin e Ministrave.

Ky Rekomandim u shpall sot më./6/10/2015

